

Rregullore

Shorteu “Sigurohu Online dhe Fito”

Shoqëria SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA kërkon t’ju parashtrojë projektin për shorteun e “Sigurohu Online dhe Fito” nëpërmjet të cilit kjo qendër fton dhe informon klientët e saj të marrin pjesë në këtë shorte që do të nisë me datë 15.12.2022-08.12.2023, Online

Kjo rregullore hartohet në bazë të VKM nr.196 datë 15.03.2017

Ky shorte do të ketë një shtrirje kohore nga data 15.12.2022-08.12.2023, ku pjesëmarrësit do të fitojnë disa çmime të cilat do të ndahen çdo muaj në datë 10. Në rastet kur data 10 është ditë pushimi shorteu do të shtyhet në ditën pasardhëse pune.

Si më poshtë rregullorja:

Periudha: 15.12.2022-08.12.2023

Pranueshmëria: Shorteu është i hapur për të gjithë pjesëmarrësit të cilët do të bëjnë blerje të sigurimeve online.

Duke marrë pjesë në shorte, të gjithë pranojnë termat dhe kushtet e rregullave të mëposhtme të Shorteut dhe pranojnë t’u përmbahen atyre:

1. Loja do të zhvillohet nga data 15.12.2022-08.12.2023
2. Lloji i lojës promovionale se dhe nga vete emri do të jetë e tillë që:
Me blerjen e siguracioneve online tek shoqëria SIGAL UNIQA Group Austria bëhesh pjesë e shorteut për të fituar një nga çmimet e poshtë shënuara.
3. Periudha e lojës promovionale do të jetë 1 vjeçare e cila do të fillojë nga data 15.12.2022 deri më 08.12.2023.
4. Për të marrë pjesë në shorte, pjesëmarrësit duhet të blejnë online siguracionin, Shtëpi, Shëndet, Makinë. Të gjithë ata që blejnë online me kartë bankare një siguracion gjatë periudhës 12 mujore e cila do të nisë pas marrjes së lejes nga autoriteti përkatës, të promovionit bëhen pjesë automatikisht të shorteut.
5. Çmimet e siguracioneve do të variojnë nga 0.4% deri në 0.9% të vlerës së objekteve të siguruar. Për çmimet e siguracioneve të shëndetit, çmimet do të variojnë nga 200 euro deri në 800 euro për vlerë mbulimi nga 50.000 deri në 150.000 euro.
6. Për siguracionet motorrike do të jetë bashkëngjitur rregullores edhe lista e primeve përkatëse.

7. Shorteu do të realizohet live në FB në adresën **Sigal Uniqa** dhe Shqipëria Live me **datë 10 të çdo muaji pasardhës, në orën 11:00**. (Në rastet kur data 10 është ditë pushimi shorteu do të shtyhet në ditën e rradhës të punës). Lista emrave të blerësve do të merret e plotë nga shitja online dhe departamentet e marrjes në sigurim. Fituesit do t'i publikohen emrat me vete gjithashtu dhe do të njoftohen me email, ashtu dhe nëpërmjet numrit të tyre të celularit të cilën e kanë depozotuar gjatë lidhjes së kontratës online.
8. Numri i pjesëmarrësve do jetë mbi 250 persona, dhe personat që do të marrin pjesë do jenë ata të cilët do të blejnë sigurime tek kompania SIGAL UNIQA Group Austria nëpërmjet sistemit të shitjes së sigurimeve online.
9. Në shorte do të jepen çmimet si më poshtë:

Në muajte kur kombetarja ka ndeshje do të dhurohen bileta për ndeshjet.

Data e ndeshjeve të kombetares janë si mëposhtë:

- A. 17 Qershor 2023 Shqipëri-Moldavi,
- B. 10 shtator 2023 Shqipëri – Poloni,
- C. 12 Tetor 2023 Shqipëri – Çeki
- D. 20 Nëntor 2023 Shqipëri – Ishujt Faroe

Çmimet që do të shpërndahen për fituesit do të jenë:

1. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **12 -100 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **2 bileta pas porte për çdo fitues, 2,000 LEKE (1,670 LEKE PA TVSH) (10 fituese, gjithsej 20 bileta)**
2. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **101-500 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **2 bileta në tribune për çdo fitues 5,000 LEKE (4,170 LEKE PA TVSH) (5 fitues, gjithsej 10 bileta)**
3. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **mbi 501 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **2 bileta VIP për çdo fitues 20,000 LEKE (16,670 LEKE PA TVSH) (2 fitues, gjithsej 4 bileta)**

Nga çdo datë 10 të muajve që nuk do të ketë ndeshje (janar 2023, shkurt 2023, mars 2023, prill 2023, maj 2023, korrik 2023, gusht 2023, nëntor 2023 dhe deri me datë 8 dhjetor 2023), SIGAL do të dhurojë

1. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **12- 100 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **1 paketë Telehendet Falas** (PAKETA 2,500 LEKE) **(10 fituese)**
2. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **101-500 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **1 check up Falas** 5,000 (4,170 LEKE PA TVSH) lekë **(5 fitues)**
3. Klientët që kanë blerë siguracion me prim **mbi 501 euro**: bëhen pjesë e shorteut për të fituar **1 sigurim Prone** 10,000 lekë **(2 fitues)**

10. Shorteu dhe shpallja e numrit fitues do të zhvillohet në praninë e një përfaqësuesi të Autoritetit të Mbikeqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave, përfaqësuesve të Degës Rajonale të Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë të cilët do të njoftohen nga Shoqëria SIGAL sipas kërkesave të VKM Nr.196 datë 15.03.2017.

11. Përzgjedhja e fituesit do të bëhet nëpërmjet një platforme online Wheelofnames:
<https://Wheelofnames.com/>

Wheelofnames është një program që e përzgjedh në mënyrë të rastësishme fituesin. Pasi zgjedh një fitues, emri hiqet nga lista dhe përzgjedhet një. Shorteu do të trasmetohet premier në facebook dhe youtube në orarin e caktuar në shpallje.

12. Organizatori i Shorteut rezervon të drejtën për të verifikuar nëse fituesi i lojës plotëson të gjitha kriteret për pranueshmëri në Shorte. Vendimet e Organizatorit të Shorteut janë përfundimtare dhe nuk mund të pranohen ankesa për çështjet që lidhen me dhënien e çmimeve.

13. Duke marrë pjesë në këtë Shorte, pjesëmarrësit autorizojnë Organizatorin për përdorimin e të dhënave të tyre personale.

14. Shanset për të fituar do të jenë totalisht të rastësishme dhe në praninë publike të të gjithë pjesëmarrësve.

15. Organizatori i Shorteut mblodh të dhëna personale për pjesëmarrësit, me qëllim administrimin e këtij Shorteu.

16. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Shorteun (duke përfshirë, pa kufizim, edhe mosmarrëveshje kur Pjesëmarrësi ka vepruar në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret Zyrtare) do të zgjidhet nga Organizatori i Shorteut vetëm në diskrecionin e tij absolut. Të gjitha vendimet e Organizatorit të Shorteut do të jenë përfundimtare.

17. Ky Shorte do të organizohet në përputhje me këto Rregulla. Pjesëmarrësi duhet të jetë në përputhje me këto Rregulla, dhe do të konsiderohet se ka pranuar dhe kuptuar Rregullat e pjesëmarrjes në lojë. Kushtet e këtij Shorteu, siç është përcaktuar në këto rregulla, nuk janë subjekt i ndryshimit ose kundërshtimit nga pjesëmarrësi.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

AVNI PONARI

ADMINISTRATOR I PËRGJITHËSHËM